



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRES

Nr. 2232 Prot.

Durrës, më 20-9.2022

SHPALLJE 4

**E VENDIT TË LIRË PËR DREJTOR TË INSTITUCIONIT PUBLIK TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR (IPAP)**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës , në zbatim të Ligjit 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar, shpall vendin e lirë të drejtorit të institucionet arsimore publik të arsimit parauniversitar IPAP bashkelidhur shpalljes:

1. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për të aplikuar për vendin e lirë për drejtor të IPAP:

- a) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”, me vlerësimin jo më pak se “ Mirë”, në kualifikimin e fundit.
- b) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- c) të jetë certifikuar nga Shkolla e Drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshme përgatitor për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve për drejtimin e institucionit arsimor *ose* të jetë pranuar për të kryer atë.

d) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

1. Dokumentacioni i aplikimit për pozicionin e drejtorit në IPAP përmban:

- a) jetëshkrimin dhe kopjet e njësuara me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkelidhur këtij udhëzimi);



- b) kopjen e njëzuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) certifikatën e drejtuesit të IPAP ose vëretimin nga shkolla e Drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.
- f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Drejtori aktual i IPAP ose zëvendësuesi i tij vë në dispozicion të secilit aplikant një kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) planin afatmesëm të shkollës;
- b) planin vjetor të shkollës të vitit paraardhës;
- c) raportin vjetor të shkollës të vitit paraardhës

Dokumentacioni i aplikimit, i përcaktuar në pikën 2 ,të shkronjës B, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në ZVAP-in përkatës jo më vonë se **10 dite nga data e shpalljes**.

2. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit.

Rezultatet e verifikimit paraprak të dokumentacionit do të shpallen jo më vonë se data **02.09.2022**. Aplikantët me mungesa në dokumentacion do të njoftohen nëpërmjet e-mailit për plotësimin e dokumentacionit brenda 3 ditë pune nga data e njoftimit të verifikimit paraprak.

3. Pas vlerësimit të dosjeve aplikantët me dokumentacionin e plotë dhe të saktë do të kryejnë intervistën e strukturuar për:

Fusha e njohurive dhe aftësitë në drejtimin e institucionit mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- a) Ligji 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- b) Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2021-2026.

- c) Urdhër nr.31, datë 19.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
- d) Udhëzim nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”.
- e) Udhëzimi nr.30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- f) Udhëzimi nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar.
- g) Udhëzimi nr.3, datë 09.02.2022 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të nëndrejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.
- h) Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- i) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë.
- j) Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
4. Rezultatet përfundimtare të konkurimit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor përkatës sipas përcaktimeve në udhëzimin nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, uljes në detyrë, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar Kreu 1, shkronja C, pika 10/g.
5. Kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankim me shkrim para Komisionit brenda 3 ditëve pune nga shpallja e rezultateve të konkurrimit.
6. Procedurat e mëtejshme vazhdojnë sipas Kreut 1, shkronja D të Udhëzimit.

Bashkëlidhur lista me vendet vakante për IPAP nën varësi të DRAP Durrës .

DREJTOR

Hazbi LIKA



GRAFIKU I KONKUSEVE PER DREJTOR TE IPAP FAZA E KATËRT



NR.	DRAP	ZVAP	INSTITUCIONI ARSIMOR
1	DURRES	VORË	SHKOLLA 9-VJEÇARE PICAR
2	DURRËS	RROGOZHINË	SHMB GOSË
3.	DURRËS	RROGOZHINË	SHKOLLA 9-VJEÇARE STËRBEG
4.	DURRËS	RROGOZHINË	SHKOLLA 9-VJEÇARE GËRMENJ
5.	DURRËS	DURRËS	SHKOLLA 9-VJEÇARE HAMALLAJ
6.	DURRËS	DURRËS	SHKOLLA 9-VJEÇARE "ARTAN ZEKA"
7.	DURRËS	KRUJË	SHKOLLA 9-VJEÇARE "ILIRIA"
8.	DURRËS	RROGOZHINË	SHKOLLA 9 VJEÇARE "QAMIL GJUZI"